

VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

"R. S. & M" SH.P.K.

NUIS: K32203002I

Sot, më datë 20/12/2022, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "R. S. & M" sh.p.k, e përbërë nga ortakët të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë, si vijon:

- Rudina Dini, zotëruese e një kuote të barazvlefshme me 5% të kapitalit të shoqërisë;
- Nikolla Çaçi, zotërues i një kuote të barasvlefshme me 95% të kapitalit të shoqërisë;


në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë si dhe ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ortakët e shoqërisë në mënyrë unanime,

VENDOSËN:

1. Miratimin e transferimit nëpërmjet shit-blerjes të 1(një) kuote në masën 5% të kapitalit të shoqërisë nga ortaku Rudina Dini, tek ortaku Nikolla Çaçi, sipas kontratës së shit-blerjes të kuotave;
2. Regjistrimin e këtij vendimi sipas ligjeve në fuqi.

ORTAKËT


Rudina Dini


Nikolla ÇAÇI

KONTRATË
PËR SHIT-BLERJEN E KUOTAVE TË
KAPTALIT TË SHOQËRISË “R. S. & M” SH.P.K

Në Tiranë, sot më 20/12/2022 lidhet kjo kontratë për shit - blerjen e kuotave të shoqërisë “R. S. & M” Sh.p.k (në vijim referuar si “Kontrata”), midis Palëve të mëposhtme:

- **Rudina Dini**, shtetase shqiptare, e lindur më 26/07/1966 në Durrës, banuese në adresën: Rr. “Papa Gjon Pali”, Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, e identifikuar me kartën e identitetit me nr. Personal G65726056D (në vijim referuar si “**Shitësi**”);

Dhe

- **Nikolla Çaçi**, shtetas shqiptar, i lindur më 04/04/1957 në Gjirokastrë, banues në adresën: Rr. “Gjin Bue Shpata”, Pallati 2/6, Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. Personal E80307005E (në vijim referuar si “**Blerësi**”).

“Shitësi” dhe “Blerësi” në vijim do të referohen bashkërisht si “Palët”.

Duke qenë se:

- Shitësi dhe Blerësi janë ortakë në Shoqërinë “R. S. & M” sh.p.k, identifikuar me NUIS: K32203002I (referuar në vijim si “Shoqëria”);
- Shitësi është zotëruar i një kuote të barasvlefshme me 5% të kapitalit të Shoqërisë;
- Blerësi është ofruar të blejë kuotën e zotëruar nga Shitësi në shoqërinë “R. S. & M” Sh.p.k dhe Shitësi ka shprehur vullnetin për të t’ia shitur një kuotë të barasvlefshme me 5% të kapitalit të Shoqërisë;

Palët bien dakort për sa më poshtë vijon:

Neni 1
Objekti

1.1 Objekti kësaj kontrate është transferim i kuotave të shoqërisë, si më poshtë:

- Ortaku Rudina Dini i shet ortakut Nikolla Çaçi 1 (një) kuotë të barasvlefshme me 5% të kapitalit të saj në shoqëri, në këmbim të vlerës së përcaktuar më poshtë.

1.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi i kalojnë 1(një) kuotë në masën 5% të kapitalit të ortakut Rudina Dini në shoqërinë dhe Blerësi bëhet zotëruar i një kuote të barasvlefshme me 100% të kapitalit të shoqërisë “R. S. & M” Sh.p.k.

Neni 2

Çmimi

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotave në fjalë të shoqërisë është si më poshtë:
- Ortaku Rudina Dini i shet ortakut Nikolla Çaçi 1 (një) kuotë në masën 5% të kapitalit të shoqërisë në këmbim të shumës prej 600.000 (gjashtëqindë mijë) lek;
- 2.2 Pagesa nga ana e Blerësit do të bëhet e plotë në llogarinë bankare të Shitësit si më poshtë:
- | | |
|-------------|------------------------------|
| Përfituesi: | Rudina Muharrem Dini |
| Banka: | Tirana Bank |
| Monedha: | ALL |
| Iban: | AL91206110110000110209129001 |

Neni 3

Garancitë

- 3.1 Shitësi deklaron se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotave që po transferohen nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

- 4.1 Shitësi deklaron se me nënshkrimin e kësaj Kontrate i kalon Blerësit gjithësej 1(një) kuotë në masën 5% të kapitalit të shoqërisë në pronësi të tij, së bashku me të gjitha të drejtat e tjera të lidhura me to;
- 4.2 Blerësi fiton pronësinë mbi 1(një) kuotë në masën 5% të kapitalit të shoqërisë me të drejta të plota të Kuotës dhe të drejtave që burojnë prej saj në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 5

Konfidencialiteti

- 5.1 Palët zotohen për ruajtjen e konfidencialitetit në lidhje me aktivitetin e shoqërisë, si dhe marrin përsipër të kujdesen që asnjë informacion, material ose dokument tjetër, i disponueshëm nga shoqëria, t'i bëhet i disponueshëm palëve të treat të paautorizuara.

Neni 6


Të ndryshme

- 6.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi Nikolla Çaçi bëhet pronar ligjshëm, sipas legjislacionit shqiptar, në total, i 100 % të kapitalit të shoqërisë, ndërsa Shitësi Rudina Dini zhvishet nga çdo e drejtë mbi 5% të kapitalit të shoqërisë të cialt me anë të kësaj kontrate i kalojnë Blerësit;
- 6.2 Kjo Kontratë është hartuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar shqiptar dhe për çështje, të cilat nuk janë rregulluar posaçërisht në këtë kontratë, Palët do ti referohen legjislacionit shqiptar në tërësi;

- 6.3 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis Palëve në lidhje me këtë Kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim midis Palëve. Në rast të kundërt, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- 6.4 Kontrata nënshkruhet nga Palët, sot, në 2 (dy) kopje origjinale në shqip.

Emrat dhe Nënshkrimet

SHITËSI



Rudina Dini



BLERËSI



Nikolla Çaçi

